



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura III**

Komisioni për Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës  
Mbledhja nr.03  
Prishtinë, më 09 Dhjetor 2009  
Ndërtesa e Kuvendit, N-225  
Mbledhja filloi në orën 11:00

**P R O C E S V E R B A L**

I mbledhjes së Komisionit për Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës

**Morën pjesë:** Berim Ramosaj, Gjylnaze Sylja, Adem Salihaj, Ramadan Avdiu, Adem Salihaj, Rita Hajzeraj, Nait Hasani dhe Zylfi Merxha.

**Munguan:** Slopodan Petroviç .

**Nga Zyra Mbështetëse morën pjesë:** Nur Çeku, Antigona Ibraj, Fatbardha Boletini.

**Mbledhjen e kryesoi:** Berim Ramosaj, kryetar i komisionit.

**Rendi i ditës**

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbaleve të dt.06.11.2009 dhe 24.11.2009
3. Prezantimi nga Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës z.Fehmi Mujota
4. Të ndryshme.

Rendi ditës u miratua pa vërejtje nga anëtarët e Komisionit me një ndryshim në renditje

nga pikat e rendit të ditës, duke e lënë si pikë të parë “Prezantimi nga Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës z. Fehmi Mujota.

## **1. Prezantimi nga Ministri i Forcës së Sigurisë z. Fehmi Mujota**

**Kryetari i Komisionit** -. E përshëndes Ministrin e Forcës së Sigurisë dhe të gjithë të pranishmit dhe i’a japë fjalën Ministrin që të bëjë një prezantim të shkurtër në lidhje me Ministrinë e FSK-së se si janë gjërat në aspektin e zhvillimit të kësaj Ministrie dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës. Ka qenë interesimi i të gjithë anëtarëve të Komisionit që ju sot të jeni prezent.

**Ministri i FSK-së-** Më lejoni që t’ju uroj për formimin e Komisionit Parlamentar dhe zgjedhjen tuaj si Kryetar i këtij Komisioni dhe anëtarëve sipas pozitive që vinë. Unë këtu jam me asistentin ushtarak kolonel Xhevahir Geci , një nga këshilltarët politik Halit Krasniqi dhe stafin përkatës. Me konsideratën më të lartë mendoj që ka qenë shumë e nevojshme vendosja e këtij relacioni të kontaktit të bashkëpunimit të formimit reciprok po edhe të mbikëqyrjes parlamentare të Forcës së Sigurisë së Kosovës ashtu siç e përcakton Kushtetuta dhe Ligjet që janë aprovuar në Parlamentin e Kosovës. Në praktikën tonë të komunikimit kemi pas një përvojë të mirë. Ministria e Forcës së sigurisë së Kosovës është Ministria më e re e formuar në kuadër të Qeverisë së Kosovës. Puna e kësaj Ministrie ka filluar me 06.08.2008 ndërsa aktivizimi i Forcës së Sigurisë, zgjedhja e Komandantit të Forcës së Sigurisë është bërë në Dhjetor të vitit 2008 dhe në Janar ka ndodh aktivizimi zyrtar i Forcës së Sigurisë. Ministria e Forcës së Sigurisë si mision ka krijimin e sigurisë në Kosovë, sigurinë e vendit, sigurinë e qytetareve të Kosovës pa dallime etnike,gjinore, religjioze dhe dallime të tjera sociale. Është një Ministri qe si model, modele të disa vendeve të Nato-s sepse është model i Ministrisë së Integruar. Kur thuhet Ministri e integruar do të thotë se është e përbërë nga shërbyesit civilë, kontrolli civil demokratik dhe nga pjesa e uniformuar. Ministria do të ketë në kapacitet të njerëzve afërsisht 150 veta te cilëve 63 vijnë me zgjedhje të veçantë me përzgjedhje nga Forca e Sigurisë sipas pozitive të parapara, sipas gradave dhe sipas nevojave që ka kjo Ministri për të ngritur kapacitetet. Pjesa tjetër që është rreth 100 është pjesa civile dhe ju e dini që Ministria është themeluar mbi bazën e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, mbi bazën gjithpërfshirëse së Pakos së Ahtisarit dhe funksionon ne bazën e ligjeve të miratuara në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Kontrolli civil demokratik është i rregulluar sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës janë të ndara mire përgjegjësitë e Presidentit si Komandant Suprem i Forcës së Sigurisë. Roli i Parlamentit në kuptimin mbikqyrës përmes Komisionit mbikqyrës së Forcës së Sigurisë natyrisht përmes formave të tjera të aprovimit të buxhetit dhe çështjeve të tjera. Është një mbikëqyrje direkte dhe parlamentare. Funksionet ekzekutive të Forcës së sigurisë sigurohen përmes rolit të Qeverisë Kryeministrit dhe Ministrin drejtpërdrejt në rolin menaxhues dhe ekzekutiv në Forcën e Sigurisë. Duke shikuar krahasimin e Ministrive të tjera që janë anëtarë të NATO-s dhe të vendeve në rajon modeli i ndërtimit të

mbikëqyrjes së sigurisë në aspektin legal është plotësisht në rregull dhe mirë e ndërtuar. Është një garanci se do të kemi një funksionim të drejtë sipas misionit, sipas objektivave dhe sipas obligimeve Kushtetuese. Përgjegjësitë janë të caktuara për themelimin e Ministrisë që nga momenti i marrjes së detyrës nga ana e Ministrit, një rol i ndarë mes Qeverisë dhe NATO-s nënkupton gjithë angazhimet, përgjegjësitë që ka pas NATO në shpërbërjen e Trupave të Mbrojtjes së Kosovës. Është një proces i cili është mbyllur që nuk ka qenë i lehtë, janë zbërthyer procese jashtëzakonisht të rëndësishme por të domosdoshme për të ndërtuar kapacitete të reja Kosovës në aspektin e sigurisë për të ndërtuar Forcën e Sigurisë sipas kriterëve dhe standardeve të NATO-s. Shpërbërjen e Trupave të Mbrojtjes së Kosovës dhe Themelimin e Ministrisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës e kemi përcjellur në mënyrë të drejtpërdrejtë, aktive me një përkrahje të fuqishme nga komanda e KFOR-it në Kosovë nga selia e NATO-s në Bruksel dhe nga të gjitha institucionet vendore. Kjo Ministri e integruar deri tani po funksionon në mënyrën e duhur dhe kemi bërë një progres jashtëzakonisht të mirë në konsolidimin e Ministrisë. Deri tani kemi arritur që të kemi 60 % të kapacitetit në funksion i cili është rezultat shumë i mirë. Kriteret e veçanta të Ministrisë së Forcës së Sigurisë. Çdo pjesëtar i Forcës së Sigurisë është pranuar mbi bazën e një konkurimi të hapur nga pjesëtari me i thjeshte deri tek komandanti i Forcës së Sigurisë. Mbi bazën e kësaj ndodh edhe me shërbyesit civilë. Çdo konkurrues në Forcën e Sigurisë kalon në procesin e selektimit dhe procesin e verifikimit. Çdo person i punësuar dhe çdo pjesëtar i Forcës do të mund të marrin kontratën fillimisht për tre vjet, pasi ta ketë kaluar kontratën me kusht. Quhet me kusht sepse kjo është faza kur mbaron procesi i verifikimit për secilën kandidat veç e veç. Ata që e mbarojnë me sukses bëhen pjesëtar aktiv me kontrate tre vjeçare. Kjo ndodh që të kemi një proces më të ngadalshëm të plotësimit të kapaciteteve, por megjithatë ne nuk jemi ndalur, vazhdimisht kemi punuar dhe tani mbi 60 % të shërbyesve civilë janë në vendet e tyre me kontrata të kushtëzuara por ka edhe të tjerë me kontrata të konfirmuara, një numër jo i vogël ndërsa me pjesëtarët e Forcës tashmë është në mbarim procesi i verifikimit dhe mbi 1200 e kanë kaluar këtë fazë dhe po presim që të mbarojë edhe pjesa tjetër. Ne kemi punuar në aspektin legal përveç atyre ligjeve që kemi miratuar në Parlament që i kanë edhe të metat e veta, janë ligje që janë derivuar nga Pako-ja e Ahtisarit, janë ligje që janë ligje që janë aprovuar me një procedure të veçantë dhe kemi pas rasti për ti korigjuar dy apo tre ligje në pjesë të caktuara për të bërë punën sa më funksionale. Jemi të kënaqur me hartimin e rregulloreve dhe deri tani kemi hartuar 19 rregullore që rregullojnë çështjen e brendshme të funksionimit të cilat janë miratuar dhe janë nënshkruar nga ana ime dhe tani kanë filluar zbatimin. Me këto rregullore, rregullohet jeta e pjesëtarëve të sigurisë, detyrat, aftësimet profesionale, kodi disiplinor dhe gjithë të tjerat që bëjnë ushtritë e NATO-s sipas një modeli të tillë. Ne nuk pretendojmë që kemi arrit këtë nivel ndonjëherë sepse do të ishim shumë jo korrekt, por jemi të orientuar në arritjet e kapaciteteve të kriterëve, standardeve të NATO-s. Forca e Sigurisë ka 2500 pjesëtare aktive sipas Kushtetutës dhe 800 pjesëtare rezervë. Komponenta aktive është e paraparë të përmbyllet deri në fund të vitit 2011. 1400 pjesëtare të ish- Trupave të Mbrojtjes së Kosovës kanë kaluar me sukses në Forcën e Sigurisë dhe këtë vit kemi pas fatin të pranojmë pak më tepër se 400 rekrut të rinj të cilët janë në përfundim të trajnimeve dhe me datën 18.12.2009 në Qendrën e Stërvitjeve në Ferizaj do të ndodhë një lloj ceremonie ku do të marrin certifikimin përfundimtar që kanë mbaruar trajnimet bazike. Kjo gjeneratë është gjenerata e parë e

rekrutëve të rinj nga shoqëria civile dhe do të ketë një lloj kalimi kompetencash në Forcën e Sigurisë së Kosovës. Me 15.09.2009 NATO ka deklaruar të arriturat e para kapacitete operacionale të Forcës së Sigurisë ndërsa kapacitet e plotë janë të parapara të arrihen në vitin 2014 sipas një pune dhe plani të brendshëm me NATO-n por pas një rishikimi është e mundur që këto kapacitete të arrihen në vitin 2012, 2500 pjesëtarë aktivë dhe 800 pjesëtarë rezervë. Kapacitetet e para janë arritur për 8 muaj. Nga Dhjetori do të kalojnë disa kompetenca që mban KFOR-i në aspektin e emergjencave, të deminimit dhe disa aspekteve të tjera që kanë të bëjnë me ndërhyrjet humanitare. Forca e Sigurisë dhe Ministria përkrahen, asistohet 24 ore nga këshilltarë ndërkombëtarë të NATO-s. Nga takimet që kemi pasur me Komandantin Suprem të NATO-s, Sekretarin Gjeneral të NATO-s dhe posaçërisht me Admiralin Fixheral që është më drejtpërdrejt përgjegjës për shumë çështje është menduar që në Kosovë është arritur një progres i duhur. Gjendja stabile në rajon, ndryshimi i klimës, rritja e mundësive të bashkëpunimit rajonal, perspektiva e partneritetit për paqe me NATO dhe shumë aspekte tjera kanë ndihmuar që të ketë zvogëlime të trupave në terren. Në vitin 2010 do të na gjejë me më pak se 10 mijë trupa në Kosovë, gjë që tregon se Kosova mbas pavarësisht është faktor i stabilitetit në rajon. Ne funksionojmë shumë mirë me Forcën e Sigurisë por nuk ka qenë e lehtë përputhje të shpejtë të mentaliteteve civilo-ushtarake. Në Ministri kemi Drejtor të Departamentit civil dhe zv. Drejtor të uniformuar dhe kundërta Drejtor të uniformuar dhe zv. Drejtor civil. Forca e Sigurisë është e vendosur në shtatë kazerma, kemi dhe hapësira të tjera. Për ne është shumë e nevojshme që mos të lëmë asgjë pa shfrytëzuar nga aspekti i infrastrukturës dhe ai logjistik. Në fokus të veçantë është pajisja, trajnimi, infrastruktura sipas standardeve të NATO-s. Objekti ku është Ministria nuk është një objekt reprezentativ për pritjen e delegacioneve të shumta që ka kjo Ministri. Ministri ceku, nënshkrimin e Marrëveshjeve të bashkëpunimit me Mbretërinë e Bashkuar me Lituaninë të cilat nuk kanë qenë të lehta. Me 24.12.2009 do të bëjmë nënshkrimin e Marrëveshjes së bashkëpunimit me Turqinë dhe jemi të hapur të bashkëpunojmë me Maqedoninë, Shqipërinë, Main e Zi në aspektin ndërkufitar dhe çështjeve të tjera. Ka edhe vende të tjera që për nënshkrimin e Marrëveshjeve të Bashkëpunimit si Holanda, SHBA, Slloveni, Kroaci etj. Kemi pas donacione nga vendet e NATO-s si Gjermania në vlerë rreth 7 milion euro në automjete, nga SHBA për uniformën, Italia, Çekia, Shqipëria, Hungaria, Finlanda, Turqia, SHBA, Luksenburgu por ka edhe vende të tjera që kanë paralajmëruar donacione në vlera të ndryshme. Përmes fondit të mirëbesimit të ngritur në Bruksel jemi përkrahur për shpërbërjen e Trupave të Mbrojtjes së Kosovës risistemimin të ish-pjesëtarëve që kanë qenë të pa sistemuar. Ne kemi shfrytëzim edhe buxhetin e Kosovës për blerje të pajisjeve të cilat pritet të kemi një pjesë të tyre në fund të këtij muaji. Rruga jonë do të jetë jo shumë e gjatë për integrim në NATO sepse po ngrejmë kapacitetet e sigurisë në këtë ombrellë të sigurisë ndërkombëtare. Po punohet edhe rreth draft planit të strategjisë së sigurisë Kombëtare, ku Ministria jonë merr pjesë aktive në grupe punuese ku ka dhënë shumë kontribut. Deri tani si pjesëtarë aktiv janë 1800 prej tyre 7.2 % i takojnë komuniteteve pakicë d.m.th 110 pjesëtarë dhe është një standard mirë i arritur që vlerësohet mirë në Bruksel. Nacionaliteti serb është ai që nguron të jetë pjesë e FSK-së. Nga komuniteti boshnjak kemi 26 pjesëtarë ose 1.7 %, turq 29 ose 1.9% ashkali 27 ose 1.8 % romë 2 ose 0.1% egjiptian 13 ose 0.9 % serb 6 ose 0.4% kroat 6 ose 0.4% goran 1 ose 0.1 që në tërësi bëjnë 7.2% të Forcës së Sigurisë dhe Ministrisë së Forcës së Sigurisë.

**Kryetari i Komisionit-** Po shihet nga ju se jeni familjarizuar dhe të involvuar shumë mirë në këtë proces.

**Gjylnaze Sylaj-** Ne duhet të kemi jo vetëm bashkëpunim por edhe përkrahje në çfarëdo situatë që ju do të ballafaqoheni me sfidat që do të keni përpara. Cilat janë prioritetet e Ministrisë për vitin 2010? Pse nuk po shkon më shpejt që të zhvillohen kapacitetet? Mendoj që të plotësohen këto kapacitete përmes Forcës tonë. Me shqetëson ngritja e bazës ushtarake të Serbisë afer kufirit e cila nuk është shenjë e bashkëpunimit paqësor. A jeni marrë ju me këtë çështje dhe a është diskutuar në Këshillin e Sigurisë? Si qëndron me Buxhet Ministria meqenëse ju ishit të kënaqur me buxhetin që është ndarë?

**Rita Hajzeraj-** Me intereson të di se kush do të marrë pjesë në këtë strategji, a do të jenë ndërkombëtare apo edhe vendore? A keni nevojë për më shumë buxhet në vitin 2010 duke pas parasysh specifikat e kësaj Ministrie? Me intereson të di se kush i ka punuar këto rregullore, a kanë pas akses ndërkombëtarët apo edhe vendorët dhe a kemi mjaft kuadro të cilët mund të punojnë këto rregullore? Çfarë nënkupton me kontrata të kushtëzuara? A ka pas persona që e kanë braktis FSK-në?

**Adem Salihaj-** Ministria e FSK-së është një atribut i veçantë i shtetësisë së Kosovës e cila ka arrit shumë deri tani dhe duket qartë që është një bashkëpunim shumë i mirë me NATO-n. Inkurajojmë Ministrin që të vazhdojë të punojë dhe ti kryjmë detyrat para afatit. Hap shumë rrugë që ne të integrohemi në strukturat e NATO-s. A ka pas ndikime politike në formimin e Forcës së Sigurisë?

**Adem Hajdaraj-** Si është gjendja me të ardhurat personale jo vetëm të stafit të administrativ por edhe Forcës së Sigurisë?

**Ramadan Avdiu-** Unë do të dëshiroja që ta falënderoja Ministrin për një ekspozitë shumë eksplicite dhe për angazhimin dhe punën që kanë bërë nga themelimi i Forcës së Sigurisë deri më sot duke e futur në efikasitet jo vetëm Forcën e Sigurisë por edhe Ministrinë. Kanë mbështetje që nga fillimi edhe nga NATO dhe kjo është një indikacion që FSK-ja do të jetë e para që do të ketë afërsi me mekanizma ndërkombëtarë përfshirë edhe NATO-n. Unë do ta inkurajoja Ministrin për punën e bërë dhe ta vë në efikasitet dhe atë 40% që i ka mbetur. Sa është arritur që të trajtohen mbetja e ish-pjesëtarëve të TMK-së që nga momenti i funksionimit të Ministrisë që të ndihmonim në riintegrimin e jetës civile të tyre të cilët nuk kanë mundur të përfshihen në FSK.

**Zylfi Merxha-** Kam nderin të jem sot para Ministrit sot, se unë kam qenë pjesë e këtyre proceseve dhe e di se si ka ardhur deri te themelimi i kësaj Ministrie. Është një sukses i madh për ne të kemi një numër prej 3300 pjesëtarëve në FSK.

**Nait Hasani-** Te arriturat janë një shprehje dhe sukses që ne jemi duke hyrë në fazën përfundimtare të trajnimeve dhe të Komandës së NATO-s dhe Forcës së Sigurisë në Kosovë.

**Kryetari i Komisionit-** Ajo çka shihet nga ekspozaja dhe nga zhvillimi i këtij institucioni del se ne jemi një hap më përpara se të gjitha vendet e tjera të cilat kanë pas forca të sigurisë apo ushtri por jo në harmoni me kriteret e NATO-s. Ne kemi shanse të ndërtojmë Forcën e Sigurisë me standarte që na i ka dhënë edhe Pakoja e Ahtisarit. Sa i përket ndërhyrjeve politike apo ndërhyrjeve të tjera në rekrutimin e pjesëtarëve të FSK-së mbetet preokupim dhe detyrë për Ministrinë mirëpo ajo çfarë më jep kurajo që Ministri është i përkushtuar në punën e tij. E kemi një benifit që NATO-n e kemi këtu dhe do doja të bashkëpunonim ngushtë me NATO-n në kuptimin që do të punojmë në ndërtimin e një force të qëndrueshme të sigurisë në Kosovë dhe të një Ministrie që vërtet do të luajë rolin e një mbikqyrësi politik të Forcës së Sigurisë dhe të ndërtimit të një strategjie për Forcat e Sigurisë në Kosovë.

**Ministri i Forcës së Sigurisë-** Krijimi, ndërtimi i kapaciteteve të Forcës së sigurisë është ndër më të vështirat në këtë periudhë kohore i cila ka qenë me shumë sfida për proceset integruese në Kosovë. Ne rrafshin praktik duhet të kemi një kujdes të matur të pjekur sepse shpejtësia e ndërtimit të kapaciteteve tona të sigurisë dhe vendimin për reduktimin trupave të Nato-s në teren janë dy procese të ndara që nuk ndikohen njëra nga tjetra. Përgjegjësinë për sigurinë e kufirit dhe çështjeve të tjera i mbanë KFOR-i përmes NATO-s. Neve na lehet hapësira që të ndërtojmë kapacitetet tona duke plotësuar standardet e NATO-s dhe është mirë të bëhen këto reduktime të pranishme fizike në aspektin militar dhe jepet hapësirë për ndërtimin e kapaciteteve të brendshme të cilat gradualisht marrin pjesë të caktuara të përgjegjësisë deri në momentin kur do të vlerësohen bashkarisht se janë arritur nivele të pjekurisë. Strategjia e sigurisë është një dokument shumë i rëndësishëm. Në hartimin e kësaj strategjie marrin pjesë të gjitha institucionet ndërkombëtare dhe vendore dhe është në rrugë për tu finalizuar. Nuk është kjo strategji e Forcës së Sigurisë por është strategji e Sigurisë së Kosovës që janë të përfshira të gjitha institucionet dhe ne japim vetëm një pjesë të kontributit për një afat më të gjatë sepse duhet të planifikojmë zhvillimet edhe në të ardhmen. Janë katër ligje bazike që janë miratuar nga Parlamenti i Kosovës dhe na kanë dhënë mundësi që të derivojmë me këto rregullore pune. Këto rregullore janë hartuar në harmoni me ligjet dhe në harmoni me modelet e rregulloreve të ushtrive të tjera dhe tani kanë filluar të zbatohen të cilat janë të bazuara në ligje dhe në Kushtetutën e Kosovës. Të gjithë këto njerëz që kanë ardhur me konkurs i nënshtrohen selektimit në bazën e paneleve të përbashkëta të Ministrisë dhe të ndërkombëtarëve. Prej momentit të pranimit mbas tre muaj është procesi i verifikimit dhe pa mbaruar ky proces nuk ka kontratë të Punës. Pagat e Ministrisë së Forcës së Sigurisë janë më të mira se në çdo institucion tjetër. Ka një dallim shërbyesit civilë kanë 5% më pak se shërbyesit e uniformuar sepse ka specifika. Numri i atyre që kanë dështuar në trajnimet bazike sillet në parametrat që ushtrojnë në çdo ushtri të NATO-s ndërsa sa e kanë lëshuar me vetë dëshirë është numër shumë i vogël. Në aspektin e selektimit kriteret kanë qenë të njëjta për të gjithë dhe besoj se kanë qenë korrekt dhe të drejta. Ne kemi pas raste që nuk kemi besuar se do të dështojnë por kanë dështuar. Verifikimi mbaron nga strukturat e NATO-s dhe ne nuk kemi qasje dhe është mirë që nuk kemi qasje. Kontaktet e drejtpërdrejta janë shumë të nevojshme dhe do të zhvillohen. 1280 veta të TMK-së që nuk janë përfshirë në Forcën e Sigurisë ku një përqindje e tyre kanë arritur moshën e pensionit të parakohshëm 45- 50 vjeç që nënkupton 50-60 % e tyre por askush nuk i'a mohon të drejtën për të konkuruar në institucionet publike apo private. Deri në

15 Qershor te vitit 2010 të gjithë i marrin pagat e plota dhe më vjen mirë që rreth 400 veta kanë gjetë punë por ende ka nevoje për risistemimin të ish-pjesëtareve dhe është mirë që të përkrahen në kushte të barabarta.

**Adem Hajdaraj-** Si ka qene rregulluar gradimi në Forcat e Sigurisë dhe si do të jetë në ardhmen?

**Ministri i Forcës së Sigurisë-** Kryesisht është ruajtja niveli i gradave të ish-pjesëtarëve të TMK-së brenda Forcës së Sigurisë ndërsa ata që marrin edukim universitar përmes kontributit të Forcës së Sigurisë ata marrin edukim të mirë profesional, bëjnë jetë ushtarake dhe maksimumi që ata marrin si gradë është pozita e nëntogerit dhe mes pas do të mund të ndodhë avancimi. Rekrutët e rinj vijnë si pjesëtar të thjeshtë.

Proçesverbali u miratua pa vërejtje nga anëtarët e Komisionit.

## **2. Të ndryshme**

**Kryetari Komisionit-** Komisioni e ka bërë një draft duke u mbështet në stafin civil Këtë draft e merrni sepse sot nuk do të diskutojmë për këtë por mbledhjen e ardhshme do të jetë pikë e rendit të ditës.

Mbledhja perfundoj ne orën 12:40 min

Përgatiti:  
Njësia Mbështetëse e Komisionit

Kryetar i Komisionit  
Berim Ramosaj